



KQZ
KQZ
U PROTOKOLLUA
NR 536 PROT
DATE 7.1.2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 1833 prot,

Shkodër, me 03 .02 .2022

V E N D I M

Nr 88 , datë 03 .02 .2022

**PËR PËRCAKTIMIN E VENDEVE PUBLIKE NË TERRITORIN E BASHKISË
SHKODËR PËR AFISHIMIN E MATERIALEVE PROPAGANDISTIKE NGA
SUBJEKTET ZGJEDHORE.**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat "dh" e "n", e 2, 78 pikat 1 e 10, dhe 79, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe vendimit nr. 6 dt 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve neni 1 "përcaktimi i kriterëve të vendndodhjes së zyrave zgjedhore, kriteret për përdorimin e materialeve propagandistike/edukuese dhe përcaktimi i listës së sendeve apo materialeve të lejuara për fushatë me vlerat maksimale për secilin prej tyre" si dhe VKB nr. 1 datë 22.01.2016 " Për Taksat dhe Tarifat Vendore në Bashkinë Shkodër " i ndryshuar

V E N D O S A

1. Përcaktimin e vendeve publike në territorin e Bashkisë Shkodër për afishimin e materialeve propagandistike nga subjektet zgjedhore sipas Aneksit 1 "Përcaktimi i vendit publik për afishimin e materialeve propagandistike zgjedhore" nga çdo zyrë zgjedhore e partisë politike apo subjektit zgjedhor përkatës, në mënyrë proporcionale, hapësirë kjo që siguron shikueshmërinë publike .
2. Materialet propagandistike zgjedhore sipas SHTOJCËS "Lista e materialeve të printuara dhe sendeve të lejuara për fushatë zgjedhore" bashkangjitur këtij vendimi, lejohen të afishohen vetëm deri në një distancë prej 5 (pesë) metrash nga zyra zgjedhore e partisë politike apo subjektit zgjedhor përkatës dhe jo më parë se 30 (tridhjetë) ditë para datës së zgjedhjeve .
3. Subjekteve zgjedhore iu lejohet të afishojnë materiale propagandistike vetëm në vendet e përcaktuara sipas Aneksit 1 "Përcaktimi i vendit publik për afishimin e materialeve propagandistike zgjedhore", në çdo zyrë zgjedhore të partisë politike apo subjekti zgjedhor përkatës.

4. Partitë politike dhe subjektet zgjedhore përkatës, me përfundimin e fushatës së zgjedhjeve marrin masa për heqjen e këtyre materialeve propagandistike zgjedhore.
 5. Subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre lejohen të ofrojnë sende dhe materiale të printuara fushate kur vlera e tyre është më e vogël se 500 (pesëqind) lekë për send material.
 6. Lista e këtyre sendeve dhe materialeve propagandistike paraqitet në Shtjçën "Lista e materialeve të printuara dhe sendeve të lejuara për fushatë zgjedhore me vlerë më të vogël se 500 lekë" që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 7. Ndalohet afishimi i materialeve propagandistike në: fasadat e godinave të banimit, institucioneve publike apo ambienteve rrethuese të tyre, brenda zonave rekreative, parqeve, në pemët e qytetit dhe në shtyllat e ndriçimit.
 8. Ndalohet afishimi i materialeve propagandistike në mjetet e transportit publik.
-
9. Policia Bashkiake ngarkohet me detyrë për të garantuar zbatimin e detyrimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, për të mos lejuar dhe për të tërhequr menjëherë çdo material statik, përfshirë posterat dhe flamujt nga çdo vendndodhje tjetër ku ato konstatohen që nuk janë vendosur në përputhje me kriteret e këtij udhëzimi të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
 10. Ky vendim i dërgohet për zbatim të gjitha subjekteve politike të regjistruara në zgjedhje.
 11. Ky vendim i dërgohet për njohje Prefektit të Qarkut Shkodër dhe Drejtorisë së Policisë Qarkut Shkodër.
 12. Ky vendim bëhet publik në faqen e internetit të Bashkisë Shkodër menjëherë pas miratimit dhe një kopje e tij i njoftohet Komisionerit Shtetëror për Zgjedhjet brenda 24 orësh nga miratimi i tij.
 13. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR



Volltarë ADEMI

SHTOJCË

| Lista e materialeve të printuara dhe sendeve të lejuara për fushatë zgjedhore me vlerë më të vogël së 500 lekë | | |
|--|--|--|
| Nr. | Emërtimi | |
| I MATERIALE TË PRINTUARA | | |
| 1 | Poster imazhi, logo përkatësie politike dhe mesazhi partia/kandidati | |
| 2 | Postera informues/edukues për programin e partisë, letër me lustër me ngjyra | |
| 3 | Fletushka për shpërndarje e mesazheve dhe premtimeve elektorale që përcjell partia/kandidati | |
| 4 | Fletëpalosje për mesazhin dhe premtimet elektorale që përcjell partia/kandidati | |
| 5 | Kartolina mesazhi/informacioni për partinë/kandidatin | |
| 6 | Kartëvizita zgjedhore për përhapjen e shpejtë të mesazhit elektorial ose kujtesë | |
| 7 | Zarfe të personalizuar që përmbajnë letër me mesazhe/ programe që përcjell partia/kandidati | |
| 8 | Broshura të ndryshme me programe të partisë/kandidatit | |
| 9 | Dosje të stampuara me logon e partisë/emërtimin e partisë/emrin e kandidatit | |
| 10 | Simbole ngjitëse stickers me logo | |
| II SENDE/MATERIALE TË LEJUARA PËR FUSHATË | | |
| 1 | Kapele të stampuar, me logo të partisë, slogan të partisë/kandidatit | |
| 2 | Bluza T-shirt stampuar, me logon dhe slogan të partisë/kandidatit | |
| 3 | Stilolapsa me logo të partisë ose sllogan | |
| 4 | Bllloqe agjende me logo/sllogan të printuar | |


REZETARIA
KIA SHKODER ES

| | | |
|----|--|--|
| 5 | Çanta të stampuara me logo dhe sloganin | |
| 6 | Maska me logon e partisë/ose imazhin e kandidatit | |
| 7 | Byzylykë me logon e partisë/ emrin e kandidatit | |
| 8 | Flamuj me dimensione të vogla me emrin dhe logon e partisë | |
| 9 | Afische ngjitëse version rrethor/katror me përmasa të ndryshme | |
| 10 | Etiketa të stampuara me logo apo slogan të partisë/kandidatit | |
| 11 | Rripa për Badges/etiketash | |
| 12 | Tullumbace të stampuara me logon/mesazhin e partisë/kandidatit | |
| 13 | Çadra të stampuara me logo | |
| 14 | Spila/Kapëse/karficë/bagdes me simbole | |
| 15 | Stema/butona të stampuara me logo | |
| 16 | Magnet me logo | |
| 17 | Mbajtëse çelësash me logo | |
| 18 | Zhurmuese, vuvuzela etj | |
| 19 | Covera/adezive të ndryshme në dimensione të vogla | |
| 20 | Mbulesa tavoline të stampuara me logo ose mesazhe | |




Formati i miratuar për stenda elektorale

SEKRETI
DASHKIA




SYRIA SE
KODER

Formati i miratuar për stenda elektorale



pamje e tabelës elektorale



pamje e stendës dhe tavolinës



Bashkia Shkodër

MIRATOHET
KRYETAR

VOLTANA ADEMI



Stenda elektorale nuk mund të jetë më e lartë se 220cm dhe më e gjërë se 200cm

Hapësira e miratuar në dispozicion të subjektit partiak, duhet të jetë në tretuarë dhe hapësira për këmbëzuar, por pa cënuar qarkullimin normal të tyre.

Bashkia Shkodër ju lutet të respektoni distancat dhe masat anti-COVID